

**ROVENA MERA**

**FUNKSIONET E KOMUNIKIMIT NË VEPRËN E DE RADËS  
TRAJTUAR NË *GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA E SHKOLLËS SË  
MESME***

**Qëllimi:** Të shohim prezantimin/respektimin e funksioneve të komunikimit në veprën me të cilën De Rada vjen në “Gjuha Shqipe dhe Letërsia” të shkollës së mesme.

**Metodologjia:** Analizë dhe krahasim i botimeve të katër shtëpive botuese të teksteve “Gjuha Shqipe dhe Letërsia” klasa 10: Pegi / Albas / Mediaprint / Centrum Production

Letërsia është një formë komunikimi. Qëllimi komunikativ është i përfshirë në vetë faktin që një vepër e shkruar apo gojore i drejtohet një publiku me përmasa të paparashikueshme. Komunikimi letrar, ndonëse në një mënyrë më të ndërlikuar, i përgjigjet skemës së përgjithshme të komunikimit gjuhësor.

Si ushtrohen apo si reflektohen funksioni emocional, funksioni nxitës, funksioni referues, funksioni metalinguistik, funksioni fatik dhe funksioni poetik në veprën “Këngët e Milosaos” me të cilën De Rada vjen në librat “Gjuha Shqipe dhe Letërsia” klasa 10 nga shtëpi botuese të ndryshme. Do të shikojmë nëse gjejnë vend në këtë vepër të gjitha këto funksione dhe si prezantohen ato tek nxënësit.

**Fjalë kyçe:** Funksioni emocional, nxitës, referues, metalinguistik, fatik dhe funksioni poetik, analizë gjuhësore.

Kohët e mëdha nxjerrin në dritë poetë të mëdhenj, të cilët shquhen për gjerësinë e tematikës që rrokin, për thellësinë e problematikës që trajtojnë dhe për forcën e artit të tyre. Pikërisht këto veçori dallojnë veprën e poetit të madh arbëresh, Jeronim de Rada (Kodra.1988:3). Pa asnjë hezitim De Rada është konsideruar si një nga përfaqësuesit e Romantizmit shqiptar, edhe pse ai lindi relativisht vonë, për shkak të kushteve të veçanta të vendit.

Romantikët shqiptarë nuk i kënduan natyrës në vetvete, por natyrës shqiptare. Ata e himnizuan atë për të ngjallur dashurinë dhe krenarinë për vendlindjen. Heroi romantik shqiptar, më tepër se një hero i velur e i zhgënjyer nga jeta aristokrate, është një hero që sakrifikon gjithçka për lirinë e atdheut. Ai përfaqësohet nga njeriu i thjeshtë, bujku, fshatari, bariu, që përpiqet ta gjejë gëzimin e jetës në vendlindje. Ashtu sikurse romantikët evropianë, edhe romantikët shqiptarë iu drejtuan thesarit të folklorit duke


fituar veçoritë dhe origjinalitetin kombëtar. Forma më e kërkuar e letërsisë romantike është poema, si thurje epiko-lirike, ku gjejmë njëherazi emocione, pamje e ngjarje (Petro, Mëniku, Marashi, Shehri 2009:248-249). Romantizmi arbëresh ndonëse u zhvillua larg tokës mëmë mbeti në thelb shqiptar nga mesazhi dhe aspiratat e heronjve romantikë. Por, ndërkohë, duke u zhvilluar përkrah letërsisë italiane, pati veçoritë e tij karakteristike.

Në librin e tij “Jeronim de Rada – jeta dhe vepra” Jup Kastrati shprehet: Kontakti me folklorin shqip për De Radën asht me shumë randësi. Ai njofti shijën artistike të popullit tone. Kështuqë, në krijimet e tia letrare ai nuk imitoi metrikën italiane, por atë të letërsisë gojore shqipe. Si rrjedhim i kangëvet popullore, i natyrës së bukur të vendit të tij dhe i dashurisë së tij të parë, lindin “Kangët e Milosaut”.(Kastarti. 1962: 4)

De Rada vjen në “Gjuha shqipe dhe Letërsia” klasa 10, me poemën epiko-lirike “Këngët e Milosaos”. Fillimisht le të prezantojmë paraqitjen grafike të veprës për të katër shtëpitë botuese të këtij teksti shkollor.

<b>ALBAS</b>	<b>Mediaprint</b>	<b>PEGI</b>	<b>CENTRUM</b>
Analizë- Këngët e Milosaos Struktura Motivi i dashurisë Motivi adhetar Idetë Sistemi i personazheve Natyra Gjuha dhe metrika Ilistrim me vargjet: Kënga I- Kangjeli I Kënga V -Kangjeli V Kënga VI Kënga XX Kënga XXX Pas cdo prezantimi këngeje është rubrika: Studim teksti	Subjekti i poemës sipas kangjelave (nga I- XXX) Studim dhe analizë teksti Thelbi kuptimor i poems: dashuria si jetë e amshuar Përmasa shpirtërore dhe poetika e veprës. Për ilustrim: Fillimi i kangjelit VIII Kangjeli X Kangjeli XIV Tragjikja e jetës dhe ballafaqimi me botën qiellore. Për ilustrim: Vargje nga kangjeli XXX Kangjeli XVIII Kangjeli XXV Kangjeli XXIV Kangjeli XV Struktura kompozicionale dhe stilistika e poemës.	Subjekti i veprës ilustruar me vargje të ndryshme nga poema Kënga I Kënga II Kënga III Kënga IV Pas secilës prej këngëve rubrika: Në labirintet e tekstit Është i vetmi botim ku është përfshirë Këngë e Serafinës	Analizë- Këngët e Milosaos Idetë dhe motivet Konflikti Rrëfimi i strukturave Personazhet Arti i poems Natyra Kënga I Kënga II Kënga V Kënga XVI Kënga XXII Kënga XXX Pas secilës këngë trajtohet rubrika: Studim teksti

Për të kuptuar funksionet e komunikimit dhe interpretimin e tyre në veprën letrare, nxënësit orientohen drejt elementeve të komunikimit përmes skemës së Jakobsonit (të njohura që në ciklin fillor).



Skema e Jakobsonit për modelet e gjuhës dallon gjashtë elementë ose faktorë komunikimi që janë të nevojshëm për komunikimin të ndodhë: (1) *një dërgues*- folës ose shkruer, është ai që prodhon mesazhin; (2) *një kod*- që është sistemi gjuhësor në bazë të të cilit prodhohet mesazhi; (3) *një mesazh*- që është thënia apo teksti gjuhësor i prodhuar në bazë të rregullave të kodit; (4) *një kontekst*- të cilit i referohet mesazhi; (5) *një kanal /kontakt*- mjet fiziko-natyror që lejon transmetimin e mesazhit; (6) *një marrës*- (dëgjues ose lexues) që merr dhe interpreton mesazhin ( Shkurtaç. 2009: 262).

Çdo faktor është pika qendrore e një lidhjeje të orientuar, ose funksion, që vepron mes mesazhit dhe faktorit. Kjo jep gjashtë funksione: (1) funksioni *referencial* është i orientuar drejt kontekstit (funksion dominues në një mesazh); (2) funksioni *emotiv (shprehës)* është i orientuar drejt atij që flet (dërguesit); (3) funksioni *konativ (mbartës)* është i orientuar drejt marrësit; (4) funksioni *fatik* shërben për të krijuar, për të zgjatur apo për të ndërprerë komunikimin (apo të konfirmojë nëse kontakti është ende atje- Hello!); (5) funksioni *metalinguistik* është përdorur për të krijuar marrëveshje të përbashkët me kodin; (6) funksioni *poetik* vë fokusin mbi mesazhin (Jacobson. 1960: 356).

Të gjashta këto funksione janë pjesë e një veprë letrare. Për ta ilustruar këtë fakt do të shikojmë dhe do të analizojmë këngët e shkëputura nga poema “Këngët e Milosaos”, me të cilat De Rada është prezantuar në librat e shkollave të mesme.

*Funksioni referencial* konsiderohet më thelbësori, qendra e komunikimit objektiv. Për të parë si realizohet ky funksion tek poema “Këngët e Milosaos” po i referohemi botimit të *Mediaprint*. Në rubrikën “Studim dhe analizë teksti”, nxënësit përballen me pyetjen:

- Cila është rëndësia e botimit të poemës “Këngët e Milosaos” si për kontekstin letrar të kohës, ashtu edhe për letërsinë shqiptare në përgjithësi ?

Leximi i plotë i poemës të bën të kuptosh që me këtë vepër, De Rada bëri hapin vendimtar për ta shkëputur letërsinë shqipe nga temat dhe skolastika fetare e së shkuarës. Me këtë perlë të letërsisë shqipe ajo periudhë që është

emërtuar rëndom nga studiuesit “Letërsia e vjetër shqiptare”, “Këngët e Milosaos” shënon të parën vepër tipike të romantizmit tonë. Me “Këngët e Milosaos” De Rada është lëvruesi i parë i poemës së kulluar lirike, apo liriko-elegjiake, një lloj i novelës në vargje. Në këtë poemë gjejmë rrënjët e para të lirikës urbane në poezinë shqiptare. (Grup autorësh-Mediaprint)

Nga m’erdh te kurmi gjith’ ky gëzim?  
Si e pafaj unë zhvishem te shtrati  
E zgjohem e hareshme se u zgjva,  
Si ajo që gdhihet me një fat të bardhë.

Romantizmi i De Radës shkon paralel me idetë çlirimtare të lirisë së popujve, në përputhje edhe me kontekstin historik të vendit.

Në botimin e *Albasit* përmes analizës së këngës së V, le të shohim hapësirën që kanë nxënësit në analizën e *funksionit emotiv* (emocional). Po t’i referohemi tekstit shkollor shohim se pas prezantimit të vargjeve të këngës së V nxënësit ftohen në një studim teksti. Në këtë këngë duken anijet turke dhe shprehet shqetësimi për fatin e vendit. Por nxënësit nxiten të bëjnë një analizë të shtresëzimeve kuptimore. Sfidohen të lexojnë mes rreshtave idenë se Atdheu mund të shpëtojë nga zgjedha turke vetëm me luftë të armatosur.

Erdhi dita e Arbrit!  
Doemos do vdesim  
Në shtrat, në mos rënçim  
Përpara shtëpive tona.

Milosao shihet si një udhëheqës, tek i cili populli mund të ketë besim. Nxënësit inkurajohen të ndjejnë dhe të kuptojnë shqetësimin e poetit për udhëheqjen e lëvizjes patriotike (Kodra. 1988:61).

Në botimin e Pegit, pas paraqitjes së këngës së I, në rubrikën “ Në labirintet e tekstit” autorët shtrojnë çështje interesante:

- Përshkruaj gjendjen euforike që ngjall poezia tek ti si lexues, duke u nisur nga evidentimi i frazave që e bartin dhe e evokojnë këtë.

- Ngjyrat që marrin pjesë në përshkrimin e natyrës janë shprehur në këtë fushë leksikore: *kaltëronte; bora; përgjaku; e bardha; deti; lule; li; qielli*. Si vijon ato në imazhin tënd, pasi ke hetuar mjete gjuhësore me të cilat shprehen - është pyetja e radhës për nxënësit.

Këto çështje ndezin tek nxënësit / marrësit, shkëndijën e diskutimit rreth *funksionit konativ* të gjuhës. Nxënësit mund të shohin të shpalosur përpara syve të tyre natyrën e shkëlqyer nga nënteksti i së cilës kuptojnë gëzimin e nënës, që mërmërit emrin e të birit nëpër shtëpi. Skena e takimit të parë të dy të rinjve nga nënteksti i së cilës kuptojmë lumturinë e parë të të rinjve, ndjenjën e dehjes së vashëz, diferencat sociale.

*Funksioni fatik* shërben për të ruajtur të hapura kanalet e komunikimit, për të ruajtur marrëdhëniet mes dhënësit dhe marrësit. Zbatimin e këtij funksioni

le ta shikojmë në botimin *Centrum*, në të cilin vargjet ilustruese janë përkthim i Shuteriqit.

Letërsia e romantikëve tanë, ku bën pjesë edhe De Rada, shquhet për diskursin e saj të zgjedhur, gamën e gjerë tematike, shprehjen e pasur gjuhësore, dhe stilin tejet të kultivuar, gjë e cila ndikoi drejtpërdrejt në ndikimin që pati kjo letërsi te lexuesi i supozuar. Kanali përmes të cilit vijnë “Këngët e Milosaos” është libri- poema në vargje, e shkruar në arbërisht dhe italisht. Poemë e përkthyer mjeshhtërisht nga autorë të ndryshëm si Dhimitër Shuteriqi, Andrea Varfi etj., me qëllimin që emocionet e kësaj vepre të mrekullueshme të Romantizmit shqiptar të vijnë deri tek lexuesit / nxënësit e ditëve të sotme.

Duke iu referuar përsëri botimit të *Albasit* le të shikojmë si mund të bëjnë nxënësit analizën e *funksionit metalinguistik*. Ata nxiten të reflektojnë mbi gjuhën dhe stilin e përdorur nga De Rada në 1836-ën. Të analizojnë rolin stilistik të shenjave paralajmëruese, pyetjeve retorike, metaforave, epiteteve, thirrimit, pasi duhet të theksojmë se bota poetike e De Radës është një poetikë e sintezës dhe e nëntekstit, një poetikë e zhbirimit në shpirtin njerëzor dhe e figuracionit befasues.

Përse të venë në det  
Mendimet, zemra ime?  
Zbardhuan, anijëzat  
Panë këndeje e u fshehën...

Duke iu referuar Adam, i cili për të treguar se nocioni i ligjërimit është më i gjerë se ai i tekstit ka dhënë një skemë e cila ka njohur sukses në një masë të madhe studiuesish,

Ligjërimi= Tekst + Kushtet e prodhimit

E. Nasufi arrin në përfundimin se “me kushte prodhimi” kihet parasysh fakti se teksti prodhohet në kushte të veçanta dhe të shumëllojshme të komunikimit. Këto kushte mund të kenë të bëjnë me folësin, me veçantitë e gjuhës në të cilën është shkruar apo është kumtuar teksti, me kohën dhe kontekstin social në të cilin prodhohet teksti... Elementet gjuhësore në tekst ndërthuren së bashku duke krijuar ndërvarësi. Pikërisht këto ndërvarësi realizojnë kohezionin gramatikor dhe atë leksikor.

Për të parë si shprehet *funksioni poetik*, marrëdhënia e mesazhit me veten, në poemën “Këngët e Milosaos” le t’i referohemi përsëri botimit të *Mediaprint*.

Në subjektin e veprës së De Radës, ngjarjet zënë pak vend... Botës së brendshme shpirtërore të heronjve, ndjenjave, parimeve, dramave të tyre u kushtohet më tepër rëndësi. Që në këngën e parë shqiptohet përjetimi kulmor i dashurisë.

Por lumbardha e Anakreontit  
Në Temp rronte e moçme.

Veç atë s' e thau bora,  
S' e përgjaku heshtëza.

Lumbardha, simbol i dashurisë i vjen Milosaos te dritarja e dhomës dhe i shenjëzon ndjenjën, të cilën nuk e kishte shfytyruar koha dhe motet. Prania e ndjeshme e natyrës në këtë vepër i përgjigjet krejtësisht konceptit krijues ë poetit. Në gjithë veprën dashuria bashkëjeton me natyrën, me bukurinë, me çiltërsinë, me madhësinë dhe me qetësinë e saj të ëmbël dhe të ngrohtë vjen përmes mesazhit të dashurisë për natyrën, për jetën dhe vendin tënd (Grup autorësh-Mediaprint). Gjithashtu veprën e përshkon si një rrymë e nëndheshme mesazhi që, nuk mund të ketë lumturi personale, kur Atdheu është i pushtuar. Le të shohim vargjet:

Doemos do vdesim  
Në shtrat, në mos rëncim  
Përpara shtëpive tona  
E nën dhe do të na harrojnë...

Ideja e çlirimit nga pushtuesi dhe nostalgjia për atdheun “matanë detit” ishte binomi mbi të cilin ishte krijuar letërsia romantike arbëreshe:

Duro, zemër, duro  
si duron mali me borë

do të intononte De Rada qysh më 1836 te poema e tij e famshme “Këngët e Milosaos”, vepër kjo e cila njëkohësisht shënon edhe fillimin e romantizmit arbëresh dhe atij shqiptar në përgjithësi.

### **Përfundime**

Letërsia është një formë komunikimi, qëllimi komunikativ i së cilës është i përfshirë në vetë faktin që një vepër e shkruar apo gojore i drejtohet një publiku me përmasa të paparashikueshme. Komunikimi letrar, ndonëse ndonëse në një mënyrë më të ndërlikuar, i përgjigjet skemës së përgjithshme të komunikimit gjuhësor.

Duke analizuar funksionin referencial të komunikimit (shqyrtuar në “Gjuha shqipe dhe letërsia 10“ botim i Mediaprint), vërejmë që me poemën “Këngët e Milosaos”, De Rada bëri hapin vendimtar për ta shkëputur letërsinë shqipe nga temat dhe skolastika fetare e së shkuarës. Romantizmi I De Radës shkon paralel me idetë çlirimtare të lirisë së popujve.

Funksioni emotiv i komunikimit (shqyrtuar në “Gjuha shqipe dhe letërsia 10“ botim i Albasit) nxit nxënësit të bëjnë një analizë të shtresëzimeve kuptimore. Të lexojnë mes rreshtave idenë e atdhetarizmit.

Erdhi dita e Arbrit!

Për të analizuar funksionin konativ të komunikimit (shqyrtuar në “Gjuha shqipe dhe letërsia 10“ botim i Pegit) përdorimi i një fushe të pasur leksikore nxit nxënësit të shikojnë të shpalosur para syve të tyre natyrën e shkëlqyer nga nënteksti i së cilës kuptohet gëzimi i nënës.

Porsi gazi që del sysh  
më zgjoi duke fërfëlluar,

kisha arrit e mëma ime  
emrin tim thosh nëpër ship.

Funksioni fatik i komunikimit (shqyrtuar në “Gjuha shqipe dhe letërsia 10” botim i Centrum) është trajtuar si mënyrë për të mbajtur të hapur kanalet e komunikimit, për të ruajtur marrëdhëniet mes dhënësit dhe marrësit. Vepra e De Radës, si pjesë e letërsisë romantike, shquhet për diskursin e saj të zgjedhur, gamën e gjerë tematike, shprehjen e pasur gjuhësore dhe stilin tejet të kultivuar, gjë e cila pati ndikim të drejtpërdrejtë te lexuesi.

Duke iu referuar përsëri botimit të Albasit nxënësit reflektojnë mbi gjuhën dhe stilin e përdorur nga De Rada në 1836 dhe shqyrtojnë kështu funksionin metalinguistik. Përmes analizës së rolit stilistik të shenjave paralajmëruese, pyetjeve retorike, metaforave, epiteteve, thirrimit theksohet se bota poetike e De Radës është një poetikë e sintezës dhe e nëntekstit, një poetikë e zhbirimit në shpirtin njerëzor dhe e figuracionit befasues

Funksioni poetik, marrëdhënia e mesazhit me veten, i shqyrtuar përsëri në botimin e Mediaprint, realizohet duke i dhënë rëndësi botës së brendshme shpirtërore të heronjve, ndjenjave, parimeve, dramave të tyre.

#### **BIBLIOGRAFI**

- A. Jashari, A. Polena, N. Gërmenji (2009), *Gjuha Shqipe dhe Letërsia 10*. Tiranë. Centrum.  
A. Riska, N. Porocani, N. Meca, H. Ciftja (2009), *Gjuha Shqipe dhe Letërsia 10*. Tiranë. Pegi.  
A. Tufa, I. Prizreni (2009), *Gjuha Shqipe dhe Letërsia 10*. Tiranë. Mediaprint.  
E. Nasufi, Punim Doktorature “*Shprehjet anaforike dhe roli i tyre në didaktikën e të lexuarit dhe të shkruarit në gjuhë të huaj*”, f. 8.  
Gj. Shkurtaj (2009), *Sociolinguistikë e shqipes*. Tiranë. Morava  
J. Kastrati (1962), *Jeronim de Rada (jeta dhe vepra)*. Tiranë. Naim Frashëri.  
K. Kodra (1988), *Poezia e De Radës*. Tiranë. Kombinati Poligrafik Shtypshkronja e Re.  
R. Jacobson, *Factors of communications and functions of language*.  
<http://www.signosemio.com/jakobson/functions-of-language.asp>  
R. Petro, L. Mëniku, A. Marashi, Dh. Shehri (2009), *Gjuha Shqipe dhe Letërsia 10*. Tiranë. Albas.

#### **LITERATURË E SHFRYTËZUAR**

- A. Varfi (1974), *Këngët e Milosaos*. Tiranë. 8 Nëntori.  
Dh. Shuteriqi (2002), *Këngët e Milosaos*. Tiranë. Argeta-LMG.  
J. Kastrati (1979), *Jeroim de Rada*. Tiranë. Mihal Duri.  
T. Plangarica (2002), *Aspekte të gjuhësisë së zbatuar*. Elbasan. Sejko.

